



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.1250/22

GJYKATA KOMERCIALE -Dhoma e Shkallës së Dytë, me gjyqtaren individuale Saranda Bogaj Sheremeti, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit Dogana e Kosovës, me seli në Prishtinë, kundër debitorit, Rr. -Mitrovicë, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, CP.nr.365/2013, i datës 10.09.2021, me datë 24.08.2022, mori këtë:

AKTVENDIM

REFUZOHET e pabazuar ankesa e debitorit, Rr. -Mitrovicë dhe VËRTETOHET aktvendimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë, CP.nr.365/2013, i datës 10.09.2021.

Arsyetim

Gjykata Themelore në Mitrovicë, me aktvendimin e ankimuar CP.nr.365/2013, i datës 10.09.2021, ka vendosur të refuzoj si të pabazuar prapësimin e debitorit, Rr. -Mitrovicë, i paraqitur kundër urdhrit përmbartimor të datës 24.05.2013.

Kundër aktvendimit CP.nr.365/2013, i datës 10.09.2021, me të cilin është refuzuar prapësimi i debitorit, me kohë ka parashtruar ankesë debitori për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljeve të dispozitave ligjore, me propozim që të aprovohet ankesa e debitorit.

Gjykata Komerciale Dhoma e Shkallës së Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 lidhur me 194 të Ligjit për Procedurë Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP), gjeti se:

Ankesa e debitorit është e pabazuar

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori ka paraqitur propozim për përmbartim në bazë të aktvendimit të Doganës së Kosovës-me nr. 04.2.3.1/06 i datës 24.01.2012, për kundërvajtje doganore.

Gjykata në shkallë të parë, sipas propozimit të kreditorit me propozimin për ekzekutim të datës 24.05.2013, ka lejuar përmbartimin duke vlerësuar se aktvendimi i Doganës së Kosovës- me nr. 04.2.3.1/06 i datës 24.01.2012, i plotëson kushtet si vendim përmbartues i dhënë në procedurë administrative.

Kundër urdhrit përmbartimor debitori ka paraqitur prapësim me datën 01.05.2021. Gjykata e shkallës së parë pas vlerësimit të prapësimin, me aktvendimin e ankimuar CP.nr.365/2013, i datës 10.09.2021, ka vendos që ta refuzoj prapësimin e debitorit i paraqitur kundër urdhrit përmbartimore CP.nr.365/21, të datës 23.04.2021.

Gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar provat të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës të ofruara nga palët ndërgjyqëse, ka vendosur që kundërshtimin e debitorit ta refuzoj si të pa bazuar duke dhënë arsye përkatëse në pjesën arsyetuese të aktvendimit të atakuar, se ne baze të dokumentit përmbartimor- aktvendimit të Doganës së Kosovës- me nr. 04.2.3.1/06 i datës 24.01.2012 për kundërvajtje doganore, i formës së prerë nga data 23.04.2013, i ekzekutueshëm nga data 23.05.2013, debitorit i është shqiptuar gjyba në shumë prej 5,000.00 Euro, të cilën është detyruar që të ja paguaj kreditorit menjëherë nga pranimi i aktvendimit në xhirollogarinë e kreditorit.

Gjykata e shkallës së parë ka konstatuar faktin se aktvendimi i lëshuar nga kreditori Dogana e Kosovës, në rastin konkret është dokument përmbartues, kjo parashihet në nenin 22 paragrafi 1 pika 1.2 të LPP-ës e cila dispozitë përcakton se: *“dokument përmbartues është edhe vendimi përmbartues i dhënë në procedurë administrative”* dhe përbënë bazën juridike për caktimin e përmbartimit sipas nenit 21 duke i plotësuar kushtet nga neni 24 paragrafi 3 dhe 27 paragrafi 1 të po këtij ligji ku përcaktohet se: *“dokumenti përmbartimor është i përshtatshëm për përmbartim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shumat dhe koha e përmbartjes së detyrimit”*, andaj pretendimet ankimore të debitorit se gjykata ka bërë shkelje të dispozitave të LPP-ës, me rastin e refuzimit të prapësimin nuk qëndrojnë.

Në procedurën përmbartimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbartimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbartues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbartimin.

Nuk qëndrojnë pretendimet për mosplotësimin e kushteve për lejimin e përmbartimit dhe as pretendimet për gjendjen faktike sepse gjykata në procedurë përmbartimore i përmbahet parimit të rigorozitetit formal juridik, nga i cili parim rrjedh se gjykata e vlerëson përshtatshmërinë e dokumentit përmbartimor, vlerëson nëse janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e urdhrit përmbartimor dhe në procedurën sipas prapësimin gjykata e shkallës së parë vlerëson shkaqet e treguara në prapësim nga neni 71 i LPP-së.

Në rastin konkret Dhoma e Shkallës së Dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendimin e saj të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon në tërësi edhe Dhoma e Shkallës së Dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë as në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (b), (g), (j) (k) dhe (m) të LPK, dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK-ës.

Kompetenca e Gjykatës Komerciale Dhoma e Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitën e nenit 3 par. 2 të LPP, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË- Dhoma e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II.nr.1250/22, data 24.08.2022

Gjyqtarja
Saranda Bogaj Sheremeti